

Gjashtëmbëdhjet ditë aktivizëm
kundër dhunës ndaj femrave
dhe dhunës në familje
25.11-10.12. 2012

„DHUNËN, ASGJË NUK MUND TA ARSYETOJË !“

Bëne diçka për vehte dhe kthehe një faqe të re në
jetën tënde – paraqite dhunuesin !



Dhuna kundër femrave është mënyra më brutale dhe më e turpshme e shkeljes së të drejtave të njeriut. Ajo është krim kundër trupit dhe mendjes. Nuk mundemi dhe nuk duhet ti mbyllim sytë para këtij akti kriminal.

Dhuna është keqpërdorim i fuqisë. Shpeshherë dhuna për keqtrajtuesin-dhunuesin paraqet një instrument për arritjen e sjelljes së dëshiruar tek viktima. Mënyrë për ta kontrolluar sjelljen dhe jetën e saj me anë të forcës, frikësimit dhe manipulimit.

Është fakt se një prej tre femrave në mbarë botën i nënshtrohet dhunës gjinore në jetën e sajë.

Barazia gjinore është vlera e vetme që eliminon diskriminimin në shtëpi dhe në shoqëri. Ajo siguron prosperitet, paqë dhe marrëdhënie të shëndosha në suaza të familjes dhe komunitet. E siguron përparrimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë-paqës dhe sigurisë botërore.

Nëse je viktimë e dhunës në familje menjëherë kërko ndihmë dhe drejtohu te:

- Stacioni më i afërt policor
- Qendra për punë sociale
- Mjeku amë
- SOS linjat telefonike për ndihmë për viktimat e dhunës
- Këshillimore dhe qendra për ndihmë juridike
- Strehimore për femra dhe fëmijë viktima të dhunës

Dhunën mund ta paraqitni në:

Linjën Nacionale SOS 15 700 ose në numrin 15 315

„16 ditët e aktivizmit kundër dhunës ndaj femrave dhe dhunës në familje“ është një fushatë ndërkombëtare e cila fillon 25 nëntor dhe përfundon 10 dhjetor me Ditën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, e cila simbolikisht vuri në dukje se dhuna ndaj femrave është shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut.



Inicjativa qytetare e femrave ANTIKO
www.antiko.org.mk
e-mail: contact@antiko.org.mk; antico@t-home.mk



Ky publikim, u mundësua në suaza të programit CIVICA Mobilitas-implementuar nga CIRa dhe finansiarisht e mbështetur nga SDC. Mendimet e shprehura këtu janë mendime të autorit/autorëve dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e CIRa-së dhe SDC-së.